



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Zyra e Kryetarit / Kancelarija Predsednika / Mayors Office

PLANI I PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2023

Janar 2023

Fjala e Kryetarit:

Shtimja është dëshira jonë e kahmotshme për të qenë plotësisht e jetueshme sipas nevojave të të gjithë qytetarëve tanë dhe në harmoni me preferencat e të gjitha grupmohave. Ky synim mua më ka shtyrë që të kandidoj në mënyrë që banorëve t'ua bëjmë një qytet siç e meritojnë dhe një komunë që është në shërbim të tyre. Këtë vizion do ta përmbushim me patjetër dhe nuk ka asnjë sfidë, pengesë a obstrukcion që na ndalë nga ky drejtim. Sepse ne të gjithë kemi sakrifikuar nga vetja për të arritur deri këtu dhe deri tani ka qenë shumë më vështirë, mbase në sytë e dikujt e pamundur për ta paramenduar këtë hap në të cilin jemi. Në një vit të vetëm qeverisje, kemi dëshmuar se Shtimja mund të udhëhiqet pa u abuzuar me të mirën e saj publike. Kemi dhënë shembull se dyert tona janë gjithmonë të hapura, ashtu siç jemi edhe vet për ta pritur e për të diskutuar secilin që na sheh si adresë zgjidhjeje për problemet e tyre. Kemi treguar se është e mundur që qytetari të jetë jo vetëm prioriteti, por i vetmi shqetësim yni, që i japim tërë kohën e mundshme dhe duke lënë gjithçka tjetër anash. Sepse jemi plotësisht të vetëdijshëm që për shkak të një vazhdimësie të gjatë e të mbrapshtë, shumë të këqija janë stërkequr e shumë të mira janë humbur dhe plot të tjera nuk janë realizuar me qëllime të ndryshme personale, grupore apo klanore. Mirëpo, atij kapitulli i kemi dhënë përfundimisht fund të hekurt dhe jemi tejet të gëzuar që më nuk do të ketë kthim prapa dhe s'mund të ulet standardi i vendosur nga ne si udhëheqje e re dhe tërësisht e ndryshme nga e kaluara. Nevojat e Shtimes janë të mëdha e kapacitetet në funksion të përmbushjes së nevojave fatkeqësisht janë të vogla. Mirëpo, ne e zotërojmë vullnetin e palëkundur e këmbëngulësinë stoike për ta realizuar çdo zotim, me shpresën për të lëvizur edhe më tej. Për këtë jemi të bindur që mund ta bëjmë sepse të gjithë ne që e kemi marrë besimin qytetar e publik, punojmë si një ekip. Të gjithë e bëjmë më të mirën nga vetja dhe asnjëri nuk heziton të vë në dispozicion e të mos kursejë asgjë vetëm e vetëm për t'i dalë në krye platformës së përbashkët që e bën Shtimen komunë të qytetarëve dhe që i bën shtimjanët qytetarë me komunë në shërbim të tyre. Prandaj, ne do ta gjelbërojmë qytetin e do t'i ndiçojmë fshatrat, do t'i bëjmë shkollat ambiente të specializuara për mësim me mjedis të pastër e me mjete pune shkencore e laboratorike, duke mos e lënë anash sportin me palestra funksionale e me Stadium modern, gjithsesi me një përkujdesje për memorien tonë lokale kolektive duke e ndërtuar një Arkivë të qytetit bashkë me Bibliotekën e re, duke e zhvendosur Entin Special e duke ndërtuar

Qendrën e re Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe rikthimin në funksion të plotë të 4 QMF-ve. Ne do të përkujdesemi për një ambient të pastër që s'u lë asnjë vend asnjë deponie ilegale që do të ndikojë në pastrimin e ajrit për të gjithë qytetarët tanë. Plani ynë, mbase i parë në dritën e 21-vjeçarit të kaluar, mund të duket aq ambicioz sa i perealizueshëm. Mirëpo, unë zotohem se ditë pas ditë të gjithë ne do të jemi dëshmitarë të hapave konkretë të realizimit të secilës shkronjë të programit tonë. Dhe e gjithë kjo me një transparencë absolute dhe pa asnjë keqpërdorim. Sepse të tillë na duan qytetarët dhe kështu e kemi dashur ne Shtimen. Prandaj, të gjithë ne që jemi shumicë, do të marshojmë krah për krah për ta transformuar Shtimen dhe për t'i dhënë kuptim dashurisë tonë për të, vizionit tonë të përbashkët dhe jetës që e zhvillojmë këtu. Për Shtimen që do ta ndryshojmë!

Kryetari i Komunës

Qemajl Aliu

Përmbajtja:

Hyrje

Zyra e Personelit

Drejtoria e Arsimit

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Drejtoria e Shërbimeve Publike

Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

PLANI I PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2023

HYRJE

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Shtimës nr. 01-06/1636 të datës 03.09.2008, Kryetari i Komunës ka formuar grupin punues për hartimin e Planit të Punës 2023.

Me qëllim të përmbushjes së objektivave, ky plan i Punës së kryetarit përmban aktivitete, detyra dhe ka të përcaktuar afatin kohor për realizimin e tyre, për vitin 2023.

Bazuar në Plaformën e Qeverisjes së Kryetarit dhe prioritetet e caktuara brenda saj,

Në këtë plan të punës janë përcaktuar aktivitetet dhe afatet kohore për realizimin e tyre, për vitin 2023.

Fokusi i punës do të jetë mbi bazën e arritjes së qëllimeve të përcaktuara për këtë vik kalendarik duke pasur një Administratë që ofron shërbime cilësore, duke rritur nivelin e shërbimeve digjitale - online bazuar në kërkesat e qytetarëve, njëkohësisht duke ngritur kapacitetet profesionale për një zhvillim të qëndrueshëm Ekonomik, planifikim urban dhe rural, mbrojtje të mjedisit, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimev e komunale. Ofrimin e arsimit parauniversitar (parashkollor, fillor e të mesëm ulet dhe të lartë). Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ofrimin e shëndetit primar shëndetësor, kujdesin për strehim, të moshuarit, fëmijët,, punësimin, banimin pulik, aktivitetet kulturore, sportive, rininë. Transportin lokal publik dhe taksitë, emërimin e rrugëve,,

	<p>rrugicave si dhe vendeve të tjera publike, ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike, turizmit.</p>
<p>GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Kryetarit - Qemajl Aliu - Zyra e Nënkyetarit - Faruk Beqa - Drejtori i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme - Valon Januzi - Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik - Kastriot Shabani - Drejtori i Drejtorisë për Arsim - Yllka Fejzullahu - Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport - Albana Fazliu - Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini - Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Isa Haxhiu - Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike - Bardhyl Rushiti - Drejtorja për Inovacion dhe Zhvillim të Projekteve - Albana Ademaj - Drejtori i Prokurimit Publik - Jeton Raka - Shefe e Kabinetit - Anita Kurti - Zyra për Financa - Bujar Ferati - Zyra e Personelit - Naim Hasani - Zyra për Komunitete dhe Kthim - Ibrahim Demiri - Zyra për Informim Publik - Lulzim Sahiti

	- Zyrtaari për Marrëdhënie me Publikun – Bajrush Rrahmani
QËLLIMI	Qëllimi i këtij plani për vitin 2023 është që Zyra e Kryetarit të Komunës të ushtrojë me sukses përgjegjësitë dhe detyrat e punës dhe t'i realizojë në tërësi objektivat e parapara; të ketë nën mbikëqyrje dhe të kontrollojë të gjitha programet, projektet, shërbimet dhe aktivitetet e Komunës; duke zbatuar ligjet dhe udhëzimet administrative në lidhje me qeverisjen komunale dhe në ushtrimin e kompetencave të duhura të Kryetarit në zbatimin e politikave dhe programeve të miratuara dhe kështu të vazhdojë përmbushjen e misionit të Kabinetit të tij.
PRIORITETET BAZË	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i infrastrukturës ekonomike dhe sociale; • Terheqja e investimeve në bashkëpunim me diasporën; • Përkrahja e fermerëve me subvencione, krijimi i kushteve për rritjen e prodhimit dhe cilësisë të produkteve bujqësore; • Zgjerimi i gamës së inkasimit të të hyrave buxhetore të Komunës dhe menaxhimi në mënyrë transparente; • Kycja e banorëve të lagjeve dhe fshatrave në sistemin e kanalizimit dhe ujësjellësit; • Mbështetja e bizneseve në hapjen e vendeve të reja të punës. • Rregullimi i rrugëve, trotuareve dhe ndriçimit në fshatra dhe në qytet; • Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave; • Mbrojtja, menaxhimi i burimeve natyrore dhe mjedisit;
OBJEKTIVAT	<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi urban, hartat zonale, lëshimi i lejeve për ndërtim dhe i lejeve për biznese;

- Ofrimi i shërbimeve administrative të shpejta dhe cilësore duke rritur nivelin e digjitalizimit për qytetarët e komunës së Shtimes;
- Ofrimi i shërbimeve publike komunale të ujësjellësit, kanalizimit, trajtimit të ujërave të zeza, infrastrukturës rrugore lokale, trotuareve, ndriçimit, stazave të biçikletave, transportit;
- Ndërtimi i infrastrukturës për krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik lokal, zonat e biznesit, zonat për bujqësi, blegtori, turizëm dhe zhvillim rural;
- Përmirësimi i infrastrukturës shkollore për fëmijët parashkollor, fillor, të mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë;
- Përmirësimi i kushteve infrastrukturore dhe furnizimeve të kujdesit primar shëndetësor;
- Implementimi i planit lokal të veprimit në mjedis, mbrojtja lokale e ambientit;
- Identifikimi, evidentimi dhe menaxhimi i pronës komunale;
- Vazhdimi i implementimit të projekteve infrastrukturore;
- Ofrimi i shërbimeve sociale dhe të banimit për kategoritë në nevojë;
- Ofrimi i shërbimeve sociale dhe të banimit;
- Mbështetja e aktiviteteve kulturore, sportive dhe të rinisë;
- Mbështetja dhe avancimi i vlerave njerëzore dhe qytetare;
- Vendosja e marrëdhënieve për bashkëpunim me të gjitha organizatat qeveritare, joqeveritare dhe ato

ndërkombëtare si: USAID, GIZ, UNDP, HELVETAS, etj. për arritjen e rezultateve në punë;

- Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndetit publik;
- Organizimi i panairove dhe funksionalizimi i tregjeve;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve të zjarrfikësve, shërbimet për mirëmbajtjen e parqeve, hapësirave publike dhe varrezave;
- Forcimi i sektorit të biznesit duke ofruar klimë të favorshme investimi.
- Promovimi dhe sigurimi i zhvillimit të marëdhënieve ndërnjerëzore barazisë gjinore, parandalimi dhe luftimi i dhunës në familje;
- Promovimi dhe forcimi i sistemit arsimor në të gjitha nivelet;
- Ruajtja e sigurisë publike dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe pronave.
- Forcimi i bashkëpunimit dhe ndërlidhjes ndërmjet niveleve më të larta të qeverisë, institucioneve të huaja, OJQ-ve, Ndërrmarrjeve Publike dhe sektorit privat;
- Angazhim dhe punë drejt ngritjes së cilësisë së punës dhe bashkëpunimit të brendshëm, si dhe ngritjes së kapacitetit të stafit në kryerjen e detyrave të tyre,
- Mbështetja e stafit të komunës në aplikimin e praktikave të mira të shërbimit dhe komunikimit me qytetar;
- Forcimi dhe Reduktimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë natyrore dhe Menaxhimi i situatave nga vërshimet, zjarri etj.
- Rritja e produktivitetit bujqësor nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së kullimit të tokave bujqësore, rregullimit të rrugëve të arave, nëpërmjet dhënjes së insentivave për

fremet, aplikimit të praktikave të mira, organizimit të trajnimeve, seminareve, ofrimit të shërbimeve këshillimore si dhe zhvillimit të teknologjisë së duhur për prodhimtari të integruar dhe duke aplikuar praktikat e mira bujqësore.

- Ofron mbështetje infrastrukturore (energji, rrugë ferma në treg, ura, zhvillimi i kullimit, sistemi i ujit të pijshëm, betonimi i rrugëve/rrugëve, etj.) për akses të lehtë në prodhim dhe treg.
- Forcimi i qeverisjes lokale përmes menaxhimit të financave publike dhe zhvillimi i një udhërrëfyesei drejt të gjitha niveleve të zhvillimit.
- Të krijohet një strukturë e fortë organizative të drejtorive përkatëse, që mundëson ofrimin e shërbimeve bazë duke iu përgjigjur nevojave të qytetarëve;
- Forcimi i sistemit për racionalizimin e shfrytëzimit të burimeve ujore, rritjes së kapaciteteve të prodhimit të ujit të pijes, shpërndarjes së rrjetit të ujësjelësit dhe kanalizimeve, përpunimi i ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike në të gjitha fshatrat dhe në vet qytetin e Shtimës.
- Nxitja e zhvillimit të sektorit minerar dhe racionalizimi i zhvillimit të tij pa dëmtuar shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.
- Forcimi i marrëdhënieve me OJQ-të, Ndërmarrjet publike dhe Organizatave të tjera të Shoqërisë Civile, Grupin Lokal të Veprimit për Planifikimin e Veprimit Lokal për Reduktimin e Varfërisë dhe zbatimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve buxhetore në përputhje me rregullat, rregulloret dhe qarkoret në fuqi.

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL	<p>Me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës, do të ndërmerren veprime koordinuese në mes të institucioneve komunale dhe atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbajtja e takimeve konsultative me drejtorët komunal për çështje specifike të drejtorive; • Kordinimi i aktiviteteve me institucionet qendrore; • Kordinimi i aktiviteteve me përfaqësuesit e partive në nivelin lokal; • Inspektimi i punimeve infrastrukturore në faza të ndryshme sipas planeve të veprimit dhe dinamikës së realizimit; • Udhëheqja dhe kordinimi i këshillit të drejtorëve, të grupeve punuese, organizimi dhe mbajtja e mbledhjeve të asamblesë komunale, mbledhje të komitetit për politikë dhe financa, takime formale dhe jo formale me qytetarë; • Takime dhe koordinim me përfaqësues të partive politike të nivelit lokal; • Pjesëmarrje në ceremoni zyrtare vendore si dhe të prezencës ndërkombëtare, ceremoni festive dhe raste përkujtimore.
TRANSPARENCA, KOMUNIKIMI DHE PËRFSHIRJA E QYTETARËVE NË QEVERISJE	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrje në konferenca dhe seminare me qëllim të prezantimit të punës dhe të aktiviteteve të komunës, • Identifikimi i nevojave dhe kërkesave të qytetarëve si dhe të përfshirjes së tyre në qeverisjen lokale përmes takimeve individuale dhe grupore, • Mbajtja e takimeve individuale dhe atyre grupore me qytetarë për identifikimin dhe adresimin e kërkesave të tyre

	<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i debateve publike të përcaktuara sipas rregulloreve të punës së Kryetarit por organizimi edhe i takimeve dhe debateve jo formale sipas nevojës, • Me qëllim të rritjes së transparencës dhe të qasjes sa më të madhe të medias në punën e administratës komunale do të organizohen aktivitete me gazetar (konferenca, takime formale dhe jo formale), • Organizimi i aktiviteteve, pjesmarrjes në debate në media dhe organizimi i takimeve me gazetarë me qëllim të rritjes së transparencës dhe qasjes së mediave në punën e administratës komunale. • Shoqëria civile si partner në qeverisje do të jetë e konsultuar dhe angazhuar nëpërmjet pjesëmarrjes në komisione komunale si dhe në takime në formën e konsultimit direkt, • Pjesmarrja e shoqërisë civile nëpër komisione komunale dhe konsultime të drejtëpërdrejta si partner i rëndësishëm në qeverisje • Bashkëpunimi me komunitetin fetar do të vazhdojë duke i përfshirë në takime dhe konsultime për të trajtuar mundësitë e bashkëpunimit dhe të zgjidhjes së problemeve, me të cilat ata përballen.
TAKIMI ME QYTETARË	<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i tubimeve dhe debateve të rregullta me qytetarët në periudha të caktuara gjatë vitit, për çështje të përgjithshme dhe ato specifike (të pakten dy herë në vit, Qershor - Dhjetor) • Organizimi dhe mbajtja e debateve për hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve Buxhetore, • Organizimi dhe mbajtja e debateve për hartimin e dokumenteve strategjike për Zhvillimin e përgjithshëm

	<p>Ekonomik Lokal, (takimet me ekspert të fushës së zhvillimit ekonomik, bujqësor dhe rural.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organizimi dhe mbajtja e debateve për Planifikim të Buxhetit për vitin 2023, • Organizimi dhe mbajtja e debateve me qytetarë dhe me ekspert për planifikim urban.
SIGURIA PUBLIKE	<ul style="list-style-type: none"> • Mbajtja e takimeve të rregullta me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), • Mbajtja e takime javore me përfaqësuesit e Stacionit të policisë në Shtime, • Mbajtja e takime periodike me Drejtorinë Regjionale të Policisë së Kosovës, Regjioni i Ferizajt.
ZHVILLIMI EKONOMIK	<ul style="list-style-type: none"> • Do të angazhohemi për identifikimin e institucioneve financiare vendore dhe ndërkombëtare dhe vndosjen e bashkëpunimit me to, për të promovuar zhvillimin ekonomik të komunës. Do të zhvillohen aktivitete për krijimin e kushteve të favorshme me investitor vendor, me disasporën dhe me ata ndërkombëtar për investime zhvillimin ekonomik të komunës së Shtimes. • Do të organizohen takime dhe konsultime të rregullta me bizneset lokale për të përkrahur ato në zhvillimin e tyre të qëndrueshëm.
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE DHE ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE	<ul style="list-style-type: none"> • Do të hartohet plani i takimeve me përfaqësues të ambasadave të akredituara në Kosovë, OSBE, BE, BB, FMN, Komision Evropian etj. • Gjithashtu do të organizohen vizita zyrtare jashtë vendit, me qëllim të përfaqësimit të interesave të Komunës.

Zyra e Personelit

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe ndryshimit të akteve nënligjore si: Rregullore (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Rregullore (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, Njësia e burimeve njerëzore ka shqyrtuar me përpikmëri të gjitha obligimet dhe detyrat në funksion të ndryshimit të legjislacionit dhe ka përshtatur të gjitha instrumentet e nevojshme në funksion të zbatimit të ligjit në fjalë.

Legjislacioni primar dhe sekondar që zbatohet në zhvillimin e procedurave nga Njësia e Burimeve Njerëzore

1. Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë
2. Ligji i punës Nr.03/L-212
3. Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative
4. Rregullore Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë dhe Nëpunësve të Shërbime Publike
5. Rregullore (MPB) Nr. 02/2020 për Planifikimin e Personelit
6. Rregullore (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë
7. Rregullore (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës
8. Rregullore (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë
9. Rregullore (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë
10. Rregullore (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil
11. Udhëzim Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publikë
12. Rregullore (QRK) Nr. 05/2022 për Procedurat e Konkurruese dhe Pranimi për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës
13. Etj.

Nr.	Objektiva	Aktiviteti	Afati i realizimit
01	Njësia e Burimeve Njerëzore ka zbatuar legjislacionin në fuqi	1.1 Pranimi i kërkesave dhe ndryshimet në listë të pagavë për të punësuarit në Administratën Komunale 1.2 Raporti i punës për vitin 2022 1.3 Dorëzimi i formularëve për vlerësimin e punës për të gjithë drejtorët dhe mbikqyrësit e drejtpërdrejt 1.4 Pranimi i formularëve të vlerësimit për shërbyesit e	1.1 Çdo muaj 1.2 Deri me 15 janar, 2023 1.3 Fillimi i muajit janar 1.4 Deri me 13 janar 2023

		<p>Administratës Komunale dhe vendosja e tyre në sistemin SIMBNJ</p> <p>1.5 Vazhdimi i procedurave të konkursit të cilat janë shpallur në fund të vitit 2022 deri në finalizimin e tyre</p> <p>1.6 Hartimi i planit të punës për vitin 2023</p> <p>1.7 Bashkëpunimi me Komisionin disiplinor</p> <p>1.8 Përgjigja me kohë për parashtruesit e ankesve dhe sigurimi i materialit</p> <p>1.9 Raporti i përgjithshëm i punëtorëve për vitin 2022</p> <p>1.10 Kontrollimi i dosjeve personale dhe rifreskimi i tyre</p> <p>1.11 Publikimi i konkurseve për pozitat e parapara me buxhet ose të liruara</p> <p>1.12 Futja e vazhdueshme e të dhënave në SIMBNJ</p> <p>1.13 Përgatitja e Planit të personelit për vitin 2022</p> <p>1.14 Mirëmbajtja e protokollit të zyres</p>	<p>1.5 Deri në finalizimin e procedurave</p> <p>1.6 Janar, 2023</p> <p>1.7 Varësisht prej rasteve</p> <p>1.8 Gjatë gjithë vitit</p> <p>1.9 Sipas nevojës</p> <p>1.10 Gjatë gjithë vitit</p> <p>1.11 Sipas planifikimit dhe gjatë vitit</p> <p>1.12 Në vazhdimësi</p> <p>1.13 Dhjetor, 2022</p> <p>1.14 Sipas nevojës</p>
02	NJBNJ përmes bashkëpunimit synon ngritjen e cilësisë së punës	<p>2.1 Bashkëpunimi me kryetarin, drejtorët e drejtorive për hulumtimin e burimeve njerëzore</p> <p>2.2 Bashkëpunimi e MAP dhe DASHC dhe insitucionet e tjera</p> <p>2.3 Taki i rregullt me drejtorët e drejtorive</p> <p>2.4 Bashkëpunimi me IKAP -in dhe të gjithë organizatorët e trajnimeve në të gjitha fushat gjithëherë në bashkëpunim dhe konsultim me drejtorët</p>	<p>2.1 Në vazhdimësi gjatë gjithë vitit</p> <p>2.2 Në vazhdimësi gjatë gjithë vitit</p> <p>2.3 Së paku një herë në muaj</p> <p>2.4 Në vazhdimësi gjatë gjithë vitit</p>

		<p>për trajnimin e stafit aty ku ka nevojë</p> <p>2.5 Takim me DSHMS-në. Përcjellja e punës në QKMF, vizita, vijueshmëria dhe diciplina në punë. Takime dhe konsultime të herëpshershme me Drejtorin e QKMF-së</p>	
03	NJBJ ndikon në ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore	<p>3.1 Udhëzimi i punëtorëve lidhur me të drejtat e tyre që burojnë nga legjislacioni i ri për zyrtarët publikë (shërbyesit civilë) dhe aktet nënligjore</p> <p>3.2 Pjesëmarrja e shërbyesve civilë në trajnime profesionale - Analizë</p> <p>3.3 Vlerësimi joformal-monitorimi i të gjitha drejtorive</p> <p>3.4 Monitorimi i procesit të futjes së të dhënave në SIMBNJ lidhur me pushimet vjetore</p> <p>3.5 Monitorimi i procesit të regjistrimit të të dhënave në SIMBNJ</p> <p>3.6 Udhëzim i vazhdueshëm i drejtorëve lidhur me procedurat e pushimeve vjetore</p>	<p>3.1 Mars 2023</p> <p>3.2 Maj 2023</p> <p>3.3 Qershor 2023</p> <p>3.4 Qershor 2023</p> <p>3.5 Në vazhdimësi</p> <p>3.6 Në vazhdimësi</p>
04	NJBNJ ndikon në ngritjen e performancës së punës në Administratën Komunale	<p>4.1 Analizë e vlerësimeve për gjithë stafin e Administratës Komunale</p> <p>4.2 Analizë e vijueshmërisë dhe diciplinës në punë</p> <p>4.3 Takim i rregullt me shërbyesit civilë lidhur me procedurat që burojnë nga marrëdhënia e punës</p>	<p>4.1 Shkurt, 2023</p> <p>4.2 Në vazhdimësi</p> <p>4.3 Gjatë gjithë vitit</p>

		4.4 Shqyrtimi i vështirësive në realizimin e aktiviteteve të punës	4.4 Tetor 2023
		4.5 Vlerësimi i nevojave të zyrtarëve për trajnime	4.5 Nëntor dhe dhjetor 2023

PLANI VJETOR I NEVOJAVE TË INSTITUCIONIT PËR TRAJNIME

Duke u bazuar në nevojat e institucionit, respektivisht në aftësimin profesional të nëpunësve të shërbimit civil të Komunës së Shtimes, në bazë të Planit të trajnimeve për nëpunësit civilë nga IKAP dhe në bashkëpunim me udhëheqësit e drejtpërdrejt të nëpunësve civil hartohet Plani vjetor i Trajnimeve

Titulli i pozitës për të cilën nevojitet trajnimi	Numri i nëpunësve civil që kanë nevojë për trajnim	Kursi/titulli i programit për stafin e punësuar	Arsyetimi pse nevojitet ky trajnim
Menaxher i Personelit	1	Baza ligjore e shërbimit civil, planet e personelit dhe SIMBNJ	Pajisje me njohuri
Drejtor i Qendrës për punë sociale	1	Trajnimi Procedura e përgjithshme administrative	Pajisje me njohuri
Zyrtar kryesor financiar	1	Planifikimi i buxhetit, ekzekutimi, monitorimi i buxhetit dhe analiza e indikatorëve SIMFK dhe BDMS	Avancimi i njohurive
Zyrtar i lartë ligjor	1	1. Planifikimi dhe menaxhimi strategjik; 2. Vendimarrja menaxheriale	Pajisje me njohuri
Inspektor i ndërtimit	1	Procedura administrative-shkrim ligjor	Pajisje me njohuri

Zyrtar për shërbime sociale 2	2	1.Procedura administrative-shkrim ligjor 2.Ligjet aktuale në fuqi që ndërlidhen me shërbimet sociale	Pajisje me njohuri
Zyrtar i larte për kulturë, rini dhe sport	1	Sjellje organizative, komunikimi efektiv etj.	Pajisje me njohuri
Zyrtar certifikues	1	1.Ekzekutimi, monitorimi i buxhetit dhe analiza e indikatorëve; 2.Menaxhimi i rrezikut dhe sistemi i kontrollit financiar	Avancim i njohurive
Zyrtar shpenzues dhe i pasurisë	2	1.Ekzekutimi, monitorimi i buxhetit dhe analiza e indikatorëve 2.E-pasuria	Avancim i njohurive
Zyrtar zotues	1	1.Komunikimi efektiv 2.Ekzekutimi, monitorimi i buxhetit dhe analiza e indikatorëve	Avancim i njohurive
Zyrtar i Prokurimit	3	Trajnim i avancuar për prokurimin publik	Avancim i njohurive
Zyrtar për arsimim	1	1.Komunikimi efektiv 2.Ligjet dhe Rregulloret në fuqi që ndërlidhen me fushën e arsimit	Pajisje me njohuri
Zyrtar për zhvillim	2	Efikasiteti i ofrimeve të shërbimeve administrative për qytetarët dhe bizneset	Avancim i njohurive

Udhëheqës i buxhetit dhe financave / ZKF	1	1.Planifikimi dhe menaxhimi i financave lokale 2.Analiza buxhetore	Avancim i njohurive
Udhëheqës i auditimit brendshëm	1	1.Planifikimi dhe ekzekutimi i auditimit brendshëm 2.Kontrolli i brendshëm i financave publike 3.Auditimi i brendshëm i financave publike 4.Sigurimi i cilësisë në auditimin e brendshëm	Pajisje me njohuri
Zyrtar i Personelit	1	Baza ligjore e shërbimit civil, planet e personelit dhe SIMBNJ	Avancim i njohurive
Zyrtar për integritet evropiane	1	Trajnim në fushën e integriteteve evropiane	Avancim i njohurive
Zyrtar për informim	1	Komunikimi me publikun, mediat sociale dhe komunikimi digjital	Avancim i njohurive
Zyrtar për teknologji informative	2	1.Analiza statistikore dhe interpretimi 2.Siguria në TI dhe mbrojtja e të dhënave 3.Përdorimi i sistemeve elektronike në administratën komunale	Avancim i njohurive

Drejtoria e Arsimit

Plani i Punës Njëvjeçare i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në Shtime do të ngërthejë në vete aktivitetet për përgatitjen e vitit të ri shkollor, përgatitjen e objekteve shkollore, bashkëpunimin e DKA-së me kryetarin e komunës, MASHTI-n, drejtoritë tjera komunale, me qytetarët, komunitetin e prindërve si dhe bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë, OJQ-të, mediet, komunitetin, etj. Plani i punës ka për bazë edhe elementet të cilat kanë të bëjnë me përcjelljen e trendeve të reja zhvillimore në arsim, pasurimin, furnizimin dhe shfrytëzimin e përhershëm të teknologjisë arsimore nëpër shkolla.

Pra, në këtë plan janë përfshirë të gjitha aktivitetet e planifikuara për katër nivelet shkollore sipas Sistemit Ndërkombëtar të Klasifikimit të Arsimit (SNKA):

- SNKA 0 - Klasat Parafilllore (5-6 vjeç) dhe Arsimi Parashkollor (lindje - 5 vjeç),
- SNKA 1 - Arsimi Fillor (Klasat I-V),
- SNKA 2 - Arsimi i Mesëm i Ulët (Klasat VI-IX),
- SNKA 3 - Arsimi i Mesëm i Lartë (Klasat X-XII).

Ky plan ka për bazë aktivitetet që do të realizohen në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës së Shtimes siç janë:

1. IP "Albiona Asallani" - Shtime
2. SHFMU "Abdullah Shabani" - Carralevë
3. SHFMU "Bajram Curri" - Petrovë
4. SHF "Emin Duraku" - Shtime
5. SHMU "Emin Duraku" - Shtime
6. SHFMU "Hasan Prishtina" - Godanc
7. SHFMU "Idriz Ajeti" - Pjetërshticë
8. SHFMU "Lasgush Poradeci" - Muzeqinë
9. SHFMU "Skënderbeu" - Reçak
10. Gjumnazi "Naim Frashëri" - Shtime
11. Institucioni i Arsimit dhe Aftësimi Profesional - Shtime

Plani i punës së aktiviteteve në Drejtorinë Komunale të Arsimit për vitin shkollor 2022/2023

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor								✓					DA

Funksionalizimi i çerdhes së vjetër në Bashkësinë e Pestë në Shtime					✓	✓							DA
Përrurimi i objektit të ri shkollor në Carralevë									✓				DA
Përrurimi i sallës së edukatës fizike në Petrovë									✓				DA-MASHTI
Përrurimi i sallës së edukatës fizike në Pjetërshticë									✓				DA-MASHTI
Analiza e suksesit të nxënësve gjatë vitit shkollor 2022-2023 në fund të gjysmëvejtoreve si dhe në fundin e vitit shkollor (informatë për Kuvend)	✓						✓						DA
Hartimi i dinamikës dhe përcjellja e fillimit të vitit të ri shkollor. Vizitë me kryetarin e Komunës në shkolla me qëllim të urimit të nxënësve dhe arsimtarëve									✓				DA-Zyra e Kryetarit
7 Marsi - Dita e Mësuesit			✓										Shkolla-DA
Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve në klasën e parë dhe klasën përgatitore (parafillor)					✓								Shkolla-DA
22 Prill - Dita e Tokës (Java e gjelbërimit për shkollat e komunës)				✓									DA, Komuna & Shkolla
17 Maj - shënimi i Festës së Abetares					✓								Shkolla-DA
Organizimi dhe bartja e nxënësve për garat në lëndë të ndryshme		✓	✓	✓									Shkolla-DA
Organizimi i Garës Komunale të Diturisë-2022					✓								Shkolla-DA
Shpallja e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2022/2023						✓							DA
Bashkëpunimi me MASHTI-n, dhe Inspektoratin e Arsimit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Përgatitja e projekteve për rregullim të							✓	✓	✓				DA

infrastrukturës shkollore, oborreve dhe këndeve të gjelbërta të shkollave													
Organizimi i garave shkollore në sport si në: futboll të vogël, basketboll, volejball dhe atletikë, shah, pingpong.			✓	✓	✓	✓							DA
Kompletimi dhe dërgimi i të dhënave në MASHTI me qëllim publikimi të konkursit për regjistrim të nxënësve në Gjinnaz dhe IAAP (Institucionin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional)				✓	✓								DA-MASHTI
Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme të larta						✓	✓	✓	✓				DA
Shpallja e konkursit plotësues për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme të larta								✓					DA-MASHTI
Shpallja e konkursit të rregullt për plotësimin e vendeve të lira të punës me mësimdhënës të kualifikuar	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Formimi i komisionit për përgatitjen e testit vlerësues dhe respektimit të procedurave për përzgjedhjen e personelit arsimor					✓	✓	✓	✓					DA
Organizimi dhe mbajtja e intervistës me kandidatët konkures	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Vlerësimi dhe përzgjedhja e personelit arsimor në bazë të konkursit të rregullt sipas UA	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Përgatitja e vendimeve për shkuarje në pushim vjetor të punëtorëve arsimor	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në								✓					DA

dollapë për bibliotekat shkollore													
Mirëmbajtja (rregullimi) i shkollave dhe oborreve shkollore			✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓				DA-Shkolla
Mirëmbajtja (rregullimi) i terreneve sportive				✓	✓	✓	✓	✓	✓				DA-Shkolla
Furnizimi dhe mbikëqyrja e furnizimit të nxënësve me tekste shkollore						✓	✓	✓	✓				MASHTI-DA
Themelimi i Këshillit të Prindërve të Komunës									✓				DA-Shkolla
Qarkorja e parë (15 maj – 30 qershor) me kufi buxhetor për hartimin e KAB-it					✓	✓							ZKF-DA-Shkolla
Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB)					✓	✓							ZKF-DA-Shkolla
Qarkorja e dytë buxhetore dhe planifikimi i buxhetit për vitin fiskal 2024 nëpër kategori ekonomike (1 gusht – 30 shtator)								✓	✓				ZKF-DA-Shkolla
Futja e të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Zhvillimit të Buxhetit (BDMS)								✓					ZKF-DA
Përgatitja e Planit të Prokurimit për institucionet arsimore											✓		DA-Shkolla
Furnizimi i shkollave me mjete higjienike dhe aparate për shuarjen e zjarrit	E përhershme, sipas nevojës											Shkolla-DA	
Furnizimi i shkollave me material për administratën e shkollave	Sipas kërkesave											Shkolla-DA	
Furnizimi i shkollave me karburante për gjeneratorë	Sipas kërkesave											Shkolla-DA	
Furnizimi i shkollave me materiale për zhvillimin e aktiviteteve të lira sipas prioriteteve të shkollave	Sipas kërkesave											Shkolla-DA	

Plani i punës së procesit edukativo-arsimor gjatë vitit shkollor 2022/2023

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Rregullimi i dokumentacionit për pronat e shkollave sipas sipërfaqeve kadastrale	E vazhdueshme												DA
Monitorimi i Sistemit për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA)	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Organizimi i mësimin shtesë për maturantët	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA-Shkolla
Sigurimi i një ambienti të shëndetshëm për shkollën dhe rregullimi i këndeve të gjelbërta shkollore	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA-Shkolla
Organizimi i trajnimeve për mësimdhënës në Qendrën për Ngritje Profesionale sipas prioriteteve të Planit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve të komunës së Shtimes	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA, MASHTI, KEC, AUK, USAID, GIZ
Përcjellja e braktisjes së nxënësve-detyrë e përhershme	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Bashkëpunimi me OJQ-të në fushën e realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe sigurisë së nxënësve në shkolla-detyrë e përhershme, kundër trafikimit, punës së fëmijëve në rrugë, drogës etj.	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Analiza e punës edukativo-arsimore	✓				✓		✓			✓			DA
Përcjellja e lëvizjes së personelit arsimor	I përhershëm, sipas nevojës												DA
Shpallja e konkurseve për plotësimin e vendeve të	Sipas nevojave												DA

lira të punës sipas kërkesave të shkollave														
Plotësimi i vendeve të lira të punës	Sipas nevojave												DA	
Vlerësimi i punës edukativo-arsimore të shkollave nëpërmjet vizitave dhe bashkëpunimit me prindër				✓	✓	✓				✓	✓	✓	✓	DA-Shkolla
Përgatitja profesionale e mësimeve, organizimi i trajnimeve në koordinim me MASHTI-n dhe organizatat tjera					✓	✓					✓	✓	✓	DA-Shkolla
Organizimi i vizitave studimore me stafin e DKA-së jashtë vendit						✓	✓							DA
Përcjellja e përhershme e aktiviteteve mësimore e jashtëmësimore të nxënësve nëpër shkollë	E vazhdueshme												DA-Shkolla	
Shpallja e konkurseve për personelin udhëheqës - drejtor të shkollave	Sipas nevojës												DA	
Përcjellja e realizimit të Mbrëmjes së Maturës					✓	✓								DA-Shkolla
Përgatitja për Testin Ndërkombëtar ICILS, i cili do të mbahet në shkollat: SHFMU "Emin Duraku" SHFMU "Lasgush Poradeci" dhe SHFMU "Skënderbeu"					✓	✓								MASHTI-DA
Përgatitjet për organizimin e Vlerësimit Ndërkombëtar TIMSS për nxënës të klasave të katërta (IV), i cili do të mbahet në institucionet arsimore: SHFMU "Emin Duraku" SHFMU "Lasgush Poradeci" SHFMU "Idriz Ajeti".			✓		✓									MASHTI-DA
Mbarimi i mësimit për maturanët	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI												MASHTI-DA	

Riprovimet për nxënësit që nuk kanë treguar rezultate pozitive në disa lëndë mësimore	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	Shkollat
Provimi i Maturës Shtetërore	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI-DA
Publikimi i rezultateve të provimit të maturës	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI-DA
Shqyrtimi i ankesave të nxënësve	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI-DA
Publikimi i rezultateve të ankesave	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI-DA
Testi i arritshmërisë për klasat e IX-ta	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI-DA
Paraqitja e provimit për afatin e gushtit	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	DA
Provimi i maturës-afati i dytë	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI, DA
Publikimi i rezultateve të provimit të maturës, afati i dytë	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI-DA
Shqyrtimi i ankesave të nxënësve	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI-DA
Publikimi i rezultateve të ankesave	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI-DA

Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DA-së me Kryetarin e Komunës, MASHTI-in, Drejtoritë Komunale dhe Qytetarët

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Takimet dhe konsultimet me Kryetarin e Komunës	Të përhershme, sipas nevojës												DA
Takimet e rregullta me MASHTI-in në kuadër të takimeve me drejtorët e DA-së	Të përhershme, varësisht nga ftesat												DA-MASHTI
Furnizimi me ligjet, udhëzimet administrative, vendimet dhe rregulloret që dalin nga MASHTI	Sipas nevojës												DA-MASHTI
Përcjellja e kërkesave, raporteve dhe informative	Sipas nevojës												DA-MASHTI

nga aktiviteti i DA-së në MASHTI													
Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet e Kolegjiumit të Drejtorëve të DA-ve të Kosovës	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA-MASHTI
Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)		✓		✓		✓		✓		✓		✓	DA
Pjesëmarrja në mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Shtimes	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Pjesëmarrja në mbledhjet e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Takimet e rregullta me drejtorët e shkollave fillore të mesme të ulët, të mesme të larta dhe institucionit parashkollor	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Pranimi i raporteve mujore të punës nga drejtorët e shkollave dhe shqyrtimi i tyre	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Përgatitja dhe hartimi i Draft-Planit Strategjik për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2023-2027	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA-Shkollat
Takime me Shërbimin Pedagogjik-Psikologjik	Sipas nevojës												DA
Bashkëpunimi i rregullt me drejtorët e drejtorive komunale, në veçanti me DKRS	I përhershëm, sipas nevojës												DA
Bashkëpunimi i rregullt me Zyrën e Inspektorëve të Arsimit në nivel regjional	Sipas nevojës												DA
Puna me palët, shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave	E përditshme dhe sipas nevojës												DA
Bashkëpunimi me Shoqatat e Personave me Aftësi të Kufizuar	Sipas mundësive dhe nevojës												DA

Bashkëpunimi i Drejtorisë së Arsimit me organet e sigurisë: Policinë, FSK-në, KFOR-in, OJQ-të dhe mediet

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Pjesëmarrja në debatet me temë arsimore e shoqërore, organizuar nga OJQ-të	Sipas organizimit dhe ftesës												DA
Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës	Sipas nevojës												DA
Bashkëpunimi me Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK)	Sipas nevojës												DA
Kontaktet me përfaqësues të KFOR-it dhe të organizatave ndërkombëtare	Sipas kërkesave												DA
Bashkëpunimi me organizata të ndryshme vendore e të huaja	Sipas kërkesave												DA
Bashkëpunimi me donatorë vendor e të huaj	Sipas nevojës												DA

Realizimi i projekteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve në arsim

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përmirësimi i infrastrukturës, transportit dhe sigurisë në shkolla	Në vazhdimësi												DA
Hartimi i programeve, planprogrameve dhe përgatitja e moduleve të trajnimit të mësimeve me theks të veçantë integrimi i gjinisë femërore si temë specifike	Në vazhdimësi												DA

Projektet e planifikuara për vitin 2023

Nr.	Arsim dhe shkencë	Shuma në €
1	Ndërtimi i Sallës së Edukatës Fizike në Zborc - SHFMU "Abdullah Shabani" (Faza e dytë)	DA-30.000 €

2	Ndërtimi i Sallës së Edukatës Fizike në Reçak – SHFMU “Skënderbeu” (Faza e dytë)	DA-40.000 €
3	Ndërtimi i shkollëve për Gjimnazin “Naim Frashëri” në Shtime (Rr. “Isa Boletini”)	DA-10.000 €
4	Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shkollore	DA-60.000 €
5	Ndërtimi i Sallës së Sportit në SHFMU “Hasan Prishtina” në Godanc	MASHTI
6	Adaptimi dhe ndërtimi i Çerdhes së Fëmijëve në Muzeqinë	MASHTI
7	Ndërtimi i Çerdhes së Fëmijëve në Godanc	MASHTI
8	Ndërtimi i Observatorit dhe Planetariumit të parë në Kosovë në Rashincë	MASHTI
Gjithsej:		

Buxheti i Arsimit për vitin 2023 sipas kategorive

Kodi i programit	Përshkrimi	Stafi	Paga dhe mëditje	Mallëra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale	Gjithsej
920	Arsim dhe Shkencë	486	2,957,565.00	307,135.00	106,217.00	43,500.00	140,000.00	3,554,417.00
	Granti i Përgjithshëm për Arsim		2,957,565.00	260,635.00	106,217.00	23,500.00	140,000.00	3,487,917.00
	Granti Specifik për Arsim		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Të Hyrat Vetanake		0.00	46,500.00	0.00	20,000.00	0.00	66,500.00
	Subvencionet		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
935	Administrata e Arsimit	4	28,250.00	2,285.00	0.00	43,500.00	0.00	74,035.00
	Granti i Përgjithshëm për Arsim	4	28,250.00	2,285.00		23,500.00		54,035.00
	Granti Specifik për Arsim							0.00
	Të Hyrat Vetanake					20,000.00		20,000.00
92330	Arsimi Parashkollor							0.00
	Granti i Përgjithshëm për Arsim	41	208,640.00	77,863.00	28,217.00	0.00	0.00	314,720.00

	Granti Specifik për Arsim	41	208,640.00	32,863.00	28,217.00			269,720.00
	Të Hyrat Vetanake							0.00
93180	Arsimi Fillor			45,000.00				45,000.00
	Granti i Përgjithshëm për Arsim							0.00
	Granti Specifik për Arsim	338	2,039,604.00	191,277.00	62,000.00	0.00	130,000.00	2,422,881.00
	Të Hyrat Vetanake	338	2,039,604.00	190,277.00	62,000.00		130,000.00	2,421,881.00
94380	Arsimi i Mesëm							0.00
	Granti i Përgjithshëm për Arsim			1,000.00				1,000.00
	Granti Specifik për Arsim							0.00
	Të Hyrat Vetanake	103	681,071.00	35,710.00	16,000.00	0.00	10,000.00	742,781.00

P.S. Buxheti në total për vitin fiskal 2023 është **3,554,417.00€** që krahasuar me vitin paraprak (**3,307,809.00€**) është më i lartë për **7.47 për qind**.

Drejtoria e Prokurimit Publik

Rendor i prokurimeve	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
1	Furnizim për aktivitete të ndryshme (Dita e Mjedisit, Dita e Evropës,7 Marsi)	10.02.2023	2,000.00
2	Furnizim me paisje për ri-funksionalizimin e Çerdhës së vjetër	24.01.2023	10,000.00
3	Furnizim me paisje tjera për institucionet e Komunës së Shtimës	15.02.2023	15,100.00
4	Furnizim me pemë dhe perime për Çerdhe dhe SHKSH	10.07.2023	8,000.00
5	Furnizim me buqeta lulesh	02.02.2023	1,550.00
6	Furnizim me ushqim dhe pije, me raste të organizimit, përgaditjes së koktejeve për festa në Komunën e Shtimes	02.02.2023	3,110.00
7	Furnizim me Veshmbathje	10.03.2023	7,060.00
8	Furnizim me pelet për institucionet e Komunës së Shtimes	02.06.2023	49,504.00
10	Furnizim me kompjuter, llaptop, për institucionet e Komunës së Shtimes	10.03.2023	20,242.00
11	Furnizim me Ushqim dhe Pije për shkollat e Komunës së Shtimës	16.01.2023	43,000.00
12	Furnizim mjeksore	16.01.2023	128,000.00
13	Furnizim për zyre për institucionet e Komunës së Shtimes	10.02.2023	33,200.00
9	Furnizim me drunj dekorativ dhe lule, për rregullimin e hapsirave publike dhe parqeve në institucionet e komunes së Shtimes	21.02.2023	16,450.00
14	Furnizimi me tepih, perde, per institucionet e Komunës së Shtimes	10.03.2023	3,650.00

15	Furnizim Paisje speciale mjekësore, për QKMF-në Dr. Vezir Bajrami Shtime	03.03.2023	8,000.00
16	Furnizim me oksigjen për QKMF-në në Shtime	18.01.2023	2,000.00
17	Furnizimi me material hixhenik për Institucionet e Komunës së Shtimes	02.02.2023	24,910.00
18	Furnizim me mobile për SHKSH-në	03.03.2023	1,000.00
19	Furnizim me Antifriz për ngrohje	02.02.2023	900.00
20	Furnizim me dhurata për fëmijet, për festat e fund vitit	04.01.2023	999.00
21	Furnizim me internet për disa shkolla të Komunes së Shtimes	15.03.2023	2,850.00
79	Blerja e paisjeve mjekësore për QKMF-në	20.04.2023	30,000.00
78	Blerja e veturës për QKMF-në	20.01.2023	20,000.00
81	Blerja e veturave për administratën komunale Shtime	20.01.2023	70,000.00

481,525.00

Rendor i prokurimeve	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
22	Rregullimi i paisjes për gjeodet	20.01.2023	999.00
24	Deratizimi, Dezinsektimi, Dezinfektimi i hapsirave publike dhe objekteve institucionale në Komunën e Shtimës	20.01.2023	9,500.00
25	Shërbimet shëndetësore shtëpiake-paliative dhe shërbimet sociale e rezidenciale për personat në nevojë në Komunën e Shtimës-SHKSH-QPS-QKMF	20.01.2023	115,000.00

26	Aktivitetet rekreative sociale dhe rehabilituese për rezidentët në Shtëpinë e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuar në Shtime	11.07.2023	4,000.00
27	Mirëmbajtja e infrastruktures në Komunën e Shtimës(2 vjeçare)	21.02.2023	100,000.00
28	Mirëmbajtja verore-(kositja e barit)	21.02.2023	15,000.00
29	Mirëmbajtja e varrezave	25.05.2023	5,000.00
30	Mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit	08.03.2023	20,000.00
31	Mirëmbajtja e ndriçimit publik	20.01.2023	30,000.00
32	Mirëmbajtja e parqeve dhe hapsirave të gjelbruara	30.03.2023	10,000.00
33	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve (2 vjeçare)	01.09.2023	70,000.00
34	Mirëmbajtja e pastertisë grumbullimi dhe largimi i mbeturinave	15.09.2023	42,000.00
35	Mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve	20.03.2023	8,510.00
36	Organizim për panair	20.09.2023	999.00
37	Hartimi i projekteve kryesore dhe ideore	02.02.2023	120,000.00
38	Botime dhe Publikim- Strategjia për zhvillimin ekonomik	14.04.2023	4,500.00
39	Organizimi i puntorisë - Trajnime	21.02.2023	7,500.00
40	Shërbime të byfesë	04.04.2023	6,500.00
41	Transporti i nxënësve për shkollat e Komunës së Shtimës	30.06.2023	21,735.00
42	Sigurimi i automjeteve për institucionet e Komunës së Shtimës	14.07.2023	7,750.00
43	Trajtimi i Qenve endacak në Komunën e Shtimës, vaksinimi, dehelmetizmi, matrikulimi dhe kastrim i tyre	30.03.2023	5,964.00
44	Hartimi dhe kontrollimi i testeve sipas lëndëve mësimore në garat Komunale të Diturisë	20.02.2023	1,300.00
45	Mirëmbajtja e E-kioskut	20.02.2023	6,000.00

46	Organizimi i manifestimeve të festave shtetore dhe komunale në Shtime	04.01.2023	15,000.00
47	Shërbimet e Varrimit	02.02.2023	45,000.00
48	Mirëmbajtja e IT për institucionet e Komunës së Shtimes	01.02.2023	6,150.00
49	Kontrolli i rrezatimeve të RTG-së dhe matja e dozimetra në QKMF-së Dr.Vezir Bajrami Shtime	20.03.2023	300.00
50	Mirëmbajtja dhe riparimi i RTG digital Shimaduz, Japan për QKMF-në Dr.Vezir Bajrami Shtime	20.02.2023	2,000.00
51	Lidhja e librave për shërbimin e Ofiqarisë-Administrata Komunale	20.02.2023	500.00
52	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve-Institucionet e Komunës së Shtimës	15.03.2023	15,500.00
53	Mirëmbajtja e ndërtesave	20.02.2023	35,558.00
54	Transporti i pacientëve për Hemodializë	20.01.2023	13,000.00
55	Shërbimet e informimit publik	20.01.2023	2,700.00
82	Blerja e paisjeve për digjitalizim	20.03.2023	18,400.00
90	Blerja e gjeneratorit për Palestrën Sportive	02.02.2023	10,000.00
92	Zërimi dhe ndriçimi profesional tek shtëpia e Kulturës	02.02.2023	25,000.00
23	Shërbimet e GPS për vetura të Komunës	20.04.2023	990.00

838,355.00

Rendori i prokurimeve	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës
56	Asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i ndriçimit publik dhe trotuarit në Shtime, Rr.12 Qershori, seg. i Rr.14 dhjetori, seg. i Rr.Tahir Sinani, seg. i Rr.Adem Jashari, Renovimi i sheshit Ahmet Shtimja, trotuarit në Rr.Ahmet Shtimja	06.03.2023	70,000.00
57	Rregullimi i kanalizimit në Shtime, Rr.William Walker, Rr.Ernest Koliqi	08.03.2023	52,167.00

58	Asfaltimi i rrugëve, trotuareve dhe rregullimi i ndriçimit në Godanc, Rr."17 Shkurti", seg. i Rr."Topilla", seg. i Rr."Muhaxheria", Rr."Qazim Mikullovc	09.03.2023	95,404.00
59	Rregullimi i poligonit per ciklizim te Parku Pishave	30.06.2023	60,000.00
60	Asfaltimi i rrugëve dhe trotuarit në Davidoc, Rr."Ibrahim Rugova", seg i Rr."Smajl Gorani", seg i Rr. "Emini", Rr."Baftiu", ndriçim në Rr."Sadriu" dhe në Rr."Zeqë Zeqiri"	10.03.2023	60,000.00
61	Ndërtimi i urave në Petrovë, Carralevë, Muzeqinë(Rr.Haxhi Halimi) dhe Reçak	15.06.2023	60,000.00
62	Rregullimi i trotuareve dhe asfaltimi i rrugëve ne Mollopolc, Rr. Sopa, seg i Rr.Islam Neziraj, trotuari në Rr.Zona e Neredimes, trotuari nga Salla deri te Qeshmja në Mollopolc	16.06.2023	100,000.00
63	Asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i ndriçimit në Petrovë Rr.Nazim Bakiu, Rr.Xhemshir Xhemshiri, Rr.Mehdi Korani seg i Rr.Kruja	13.03.2023	80,000.00
64	Rregullimi i murit mbrojtës në Reçak afer Kompleksit dhe asfaltimi i rrugëve Rr.15 Janari, Rr.Pavarsia, kanalizimi në Rr.Dëshmorët e Reçakut	14.03.2023	60,000.00
65	Rregullimi i rrugëve dhe kanalizimit në Godanc Rr.Shtegu UÇK-së, Rr.Sopiani seg i Rr.Dëshmorët e Godancit, Rr.Marigona seg i rrugës Arsim Zeqiri (rruga e Cenëve) seg i Rr.Vëllezërit Hyseni	15.03.2023	84,000.00
66	Asfaltimi i disa segmente të rrugëve, ndriçimi dhe kanalizimi në fshatin Pjetershtice Rr.Aziz Dugolli, Rr.Rrezja, Rr.Idriz Ajeti, Rr.Isak Brahimi, Rr.Shaqir Dugolli	30.06.2023	45,000.00
67	Asfaltimi i rrugëve, trotuareve dhe kanalizim ne Lagje te Pajtimit seg i Rr.Shefket Muhadini seg i Rr.Qameria, Rr.Besim Ndreca, asfaltimi i rrugës së varrezave	04.04.2023	50,000.00
68	Rregullimi i ndriçimit në Carralevë Rr.Balaj, seg i Rr.Ali Tafa, Rr.Rrahman Tafa dhe asfaltimi rrugës te varrezat e Carraleves	12.05.2023	40,000.00
69	Rregullimi i rrugëve ndriçimit dhe kanalizimit në Zborc Rr.Hafir Bajrami, Rr.Rifat Haliti	20.03.2023	70,000.00
70	Asfaltimi i rrugëve trotuareve dhe ndriçimit në Rashincë, Rr.Cani, Rr.Burimi, Rr.Ferizajit, Rr.Beqir Rushiti, Rr.Trimat e Lirise, Rr.Qorrolli	30.03.2023	80,000.00
71	Asfaltimi i rrugëve dhe ndriçimit në Gllavicë seg i Rr.Galica, Rr.Ferati	30.05.2023	55,000.00
72	Asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i ndriçimit në Vojnovc seg i Rr.Jashari, Rr.Ulqini, Rr.Mehmeti, Rr.Bashkim Emiri	23.03.2023	75,000.00

73	Asfaltimi i rrugëve dhe trotuarit në Muzeqinë seg i Rr.Vesel Halimi, seg i Rr.Maliq Hoxha, rregullimi i kanalizimi në Rr.Fehmi Agani, Rr.Rushiti	14.04.2023	45,000.00
74	Asfaltimi i rrugëve, ndriçimit dhe trotuarit në Gjurkoc seg i Rr. Bushati, ndriçim Rr.Pjetershtica, Rr.Kastrati	28.04.2023	55,000.00
75	Asfaltimi i rrugës te varreza në fshatin Dugë dhe hapja e rrugës të kodra e Bretencit	05.06.2023	30,000.00
76	Asfaltimi i rrugës në fshatin Rancë seg i Rr.Martiret Asllani	20.06.2023	25,000.00
77	Asfaltimi i Rr.Skenderbeu, seg i Rr.Afrim Musliu dhe Rr.Emrush	25.05.2023	45,000.00
80	Renovimi i objekteve shëndetësore	22.05.2023	9,500.00
83	Rregullimi i garazhave për vetura Komunale	30.03.2023	10,000.00
84	Ndërtimi i aneks objektit të SH. Rrezidenciale	15.03.2023	20,000.00
85	Asfaltimi i rrugëve në parkun e biznesit në Gllavicë	20.01.2023	120,000.00
86	Vazhdimi Rr.Idriz Seferi, rreth liqenit Shtimes	21.03.2023	70,000.00
87	Rregullimi i rrugëve bujqësore me zhavor në fshatrat e komunës së Shtimes	30.03.2023	40,000.00
88	Regullimi i parkut të pishave në Shtime - faza IV	02.05.2023	45,000.00
89	Rregullimi i shtigjeve profesionale për çiklizëm dhe motorkros në zonat turistike	02.06.2023	70,000.00
91	Restaurimi i muzeut të qytetit në sheshin Ahmet Shtimja	30.05.2023	15,000.00
93	Rrethojat e fushave sportive në fshatrat Carralevë, Petrovë dhe Davidovc	14.04.2023	65,000.00
95	Ndërtimi parqeve në Qytete dhe fshatra Muzeqinë, Rashincë, Godanc i Poshtëm dhe i Epërm	05.05.2023	104,356.00

96	Ndërtimi dhe renovimi, objekteve shkollore, 'Emin Duraku', 'Bajram Curri', 'Hasan Prishtina' si dhe Shkolla Profesionale	30.03.2023	60,000.00
97	Renovimi i Objekti të Komunës	16.05.2023	35,000.00
98	Rregullimi i ndriçimit publik	04.04.2023	60,000.00
99	Rregullimi dhe përmirsimi i infrastrukturës në Komunën e Shtimës	03.04.2023	100,000.00
100	Rregullimi infrastrukturës në Zonën Ekonomike II	30.03.2023	60,000.00
